



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:272334

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05669993

KE.nr. 310/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit NLB Prishtina me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga A.K., jurist tek paditësi, kundër të paditurës “A...” SH.P.K, me nr. unik identifikues 810197534 dhe me seli në Klinë, fshati Pograxhë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga shoqëria e avokatëve “Pro Juris” me seli në Prishtinë, me avokat Arbër Krasniqi, me objekt kontesti regres i garancionit bankar, vlera e kontestit 157.645.74 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 17.05.2024, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të paditurit, me datën 07.05.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NLB Prishtina me seli në Prishtinë ashtu që detyrohet e paditura “A...” SH.P.K., që në emër të regresit të garancionit bankar nr. G-22-12/04 të datës 22.12.2004 dhe aneksit të tij dt. 25.07.2005, t’ia paguaj paditësit shumën prej 100.000.00 €, (njëqind mijë euro), me kamatë ligjore në lartësi prej 8% dhe atë nga data e arritshmërisë së kërkesës për regres më 25.04.2015 e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura “A...” SH.P.K, që në emër të regresimit të garancionit bankar t’ia paguaj paditësit edhe shumën prej 57.645.74 EUR, si e pabazuar.
- III. DETYROHET e paditura, që t’i paguaj paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 1,030.00 EUR (njëmijë euro), në afat prej shtatë (7) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi NLB Prishtina me seli në Prishtinë, me datë 02.02.2012 ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike kundër të paditurës NTTP “A...” B.I. me seli në fshatin Pograxhë, Klinë, me objekt kontesti regres i garancionit bankar.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin C.nr. 64/2012 të datës 24.03.2017 ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që të paguaj borxhin në shumë prej 157.645.73 EUR.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin Ae.nr. 135/2017 të datës 09.07.2019 ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditëses NLB Prishtina Sh.a ashtu që ka prishur Aktgjykimin C.nr. 64/2012 të datës 24.03.2017 të gjykatës së shkallës së parë, dhe të njëjtën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje pranë të njëjtës gjykatë.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë, mbi bazën e kompetencës lëndore është transferuar për shqyrtim të mëtejme pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, si në padi ashtu edhe përgjatë seancës përgatitore ka theksuar se paditësi në cilësi të bankës ka hyrë si garantues i marrëdhënies afariste kontraktuale në mes të të paditurit dhe subjektit të huaj Profine GmbH duke lëshuar garancionin bankar në vlerë prej 100,000.00 EUR, dhe duke marrë obligimin që sipas kushteve të cekura në garancion, në rast të paraqitjes së kërkesës, ta ekzekutoj garancionin në favor të palës shfrytëzuese Profine GmbH. Ka shtuar se paditësi, duke vepruar sipas sugjerimeve të të paditurës, nuk ka bërë ekzekutimin e garancionit në mënyrë vullnetare ndaj palës shfrytëzuese, por që me datë 03.09.2007, subjekti i huaj Profine GmbH D-53840 ka paraqitur padi ndaj paditësit për pagesën e garancionit prej 100,000.00 EUR ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut II.C.nr. 299/07 të datës 29.01.2008, i vërtetuar nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ae.nr. 122/2008 i datës 08.11.2011, këtu paditësja është detyruar që të paguaj garancionin bankar Profine GmbH D-53840 për llogari të këtu të paditurës. Ka shtuar se Përmbaruesi Privat Eset Murati, përmes Urdhrit P.nr. 582/15 të datës 23.04.2015 ka bërë transferimin e mjeteve nga paditësja për borxhin kryesor 100,000.00 EUR, për shpenzime të procedurës kontestimore shumë prej 944.20 EUR, për kamatë shumë prej 52,996.96 EUR, për

shpenzime të procedurës përbarimore shumë prej 3,704.58 EUR, apo në total shumë prej 157.645.75 EUR. Përgjatë seancës përgatitore, ka bërë precizimin e padisë në kuptim subjektiv, ashtu që si palë e paditur tani ka evidentuar subjektin “A...” Sh.P.K., kjo meqenëse biznesi NTPP “A...” B.I, është shndërruar nga biznesi individual në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Përgjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka qëndruar pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke theksuar se pas administrimit të provave, baza juridike është vërtetuar në tërësi, dhe se paditësit i ka lindur e drejta për të kërkuar regresimin e shumës së paguar për llogari të paditësit në momentin kur Përmbartuesi Privat shumë e garancionit së bashku me kamatën ligjore dhe shpenzimet e procedurës e ka inkasuar në procedurë përbarimore. Ka shtuar se me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës qartazi është vërtetuar se e drejta e paditësit nuk është e përfshirë në parashkrim, dhe se e drejta e paditësit që të kërkojë regresimin e shumës së paguar paraqet rregull ndërkombëtar për garancionet bankare që aplikohet edhe në Republikën e Kosovës “paguej sot, padit nesër”. Nga të lartcekurat, i ka propozuar gjykatës që ta miratojë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën që t’ia kthejë paditësit lartësinë e shumës prej 157.645.75 EUR edhe atë me kamatë ligjore prej 8% nga data 25.04.2015 e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar në vlerë prej 4,204.58 EUR.

I padituri me përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se në këtë çështje kontestuese, pala e paditur A... ka qenë i paditur edhe më parë nga subjekti i huaj Profine GMBH dhe për këtë çështje gjyqësore janë zhvilluar seanca, nxjerrë prova përmes ekspertizave financiare nga gjykata, me të cilën ka rezultuar se borxhi i këtu të paditurit ndaj subjektit të huaj përveç pagesës së tërësishme është paguar edhe më tepër dhe në bazë të po atyre konstatimeve profesionale është obliguar Profine GMBH që ta kthejë shumë e paguar më tepër, por që pas përfundimit të këtyre ekspertizave është marrë një aktvendim nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, I. C.nr.244/2007 të datës 27.09.2010 me të cilin është shfuqizuar aktvendimi për lejimin e përbarimit dhe është konstatuar se paditësi Profine GMBH ka tërhequr padinë.

Ka theksuar se Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin A.C.nr. 135/2017 të datës 09.07.2019 gabimisht ka bërë parafrazimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore të LMD-së sa i përket parashkrimit duke iu referuar nenit 361 të saj, pasi që me nenin 342 par.2 të LMD-së përcaktohet se “*në qoftë se detyrimi konsiston në atë se diçka të mos bëhet, të lihet pa u bërë ose të pësohet, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur debitori të ketë vepruar në*

kundërshtim me këtë detyrim”, e në interpretim të kësaj dispozite i padituri e ka njoftuar paditësen me datën 28.03.2006 me shkrim në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të kërkuara nga Profine GMBH, duke i bashkangjitur të njëjtës transaksionet bankare apo kopjet e transfereve bankare, dhe duke kërkuar që të anulohet ai garancion dhe ta njofton palën tjetër se nuk e mbështet në realizimin e atij garancioni. Pra, i gjithë detyrimi i kërkuar nga paditësi në këtë procedurë, është kërkuar nga i padituri që të mos bëhet ndaj subjektit të huaj, andaj edhe afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë me këtë kundërshtim të detyrimit të datës 28.03.2006, e rrjedhimisht edhe padia e paditësit është e parashkruar. Ka sqaruar se me pagesën e borxhit nga ana e këtu të paditurit qysh në vitin 2005 kanë përfunduar të gjitha marrëdhëniet detyrimore me Profine GMBH dhe garancioni dhe të gjitha detyrimet në bazë të këtij garancioni është dashur dhe duhet të shuhet. Ka shtuar se ka qenë lëshimi bankës apo paditëses që nuk i ka paraqitur këto prova pranë gjykatës në procedurën kur ka qenë e paditur, e të cilat prova në mënyrë të pakontestueshme konfirmojnë shlyerjen e detyrimit të borxhit të kërkuar, pra vetë banka ka dështuar të prezanton prova dhe argumente tjera relevante të cilat i ka pasur në posedim qysh në vitin 2006. Këtë fakt e pranon edhe paditësi me parashtrësën e tij nr.1512 të datë 12.06.2016 në të cilën në pasuesin e tretë paditësi deklaron “paditësi është koshient se e paditura kërkesën me baze garancioni G-22 112/04 e ka përmbushur një herë ndaj subjektit Profine GMBH...”. Andaj kjo çështje është vërtetuar përveç se nga paditësja po ashtu edhe me ekspertiza financiare të nxjerra nga gjykata dhe atë ekspertiza e datës 21.05.2007, plotësimi i datës 25.06.2009, dhe ekspertiza e datës 18.05.2010. Gjykatës i ka kërkuar që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar në shumë prej 748.80 EUR.

2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Garancioni me nr. G-22.12/04 i datës 22.12.2004; Aneksi i garancionit i datës 21.07.2005; Kërkesa e të paditurës drejtuar paditësit për mos ekzekutim të garancionit e datës 28.03.2006; Aktgjykimi II.C.nr.299/07 i datës 29.01.2008; Aktgjykimi Ae.nr.122/2008 i datës 08.11.2011 nga Gjykata Supreme e Kosovës; urdhëresë për transferim të mjeteve monetare Pnr.582/15 e datës 23.04.2015, së bashku me propozimin për përmbarim të datës 22.04.2015; Pasqyrë bankare e lëshuar nga BQK për llogarinë bankare të paditëses; Aktvendimi I.C.nr.244/2007 i datës 27.09.2010; parashtrësja e të paditurit drejtuar Profine GMBH; ekspertiza financiare e datës 21.05.2007 nga Eksperti F.T. e përpiluar në lëndën

I.C.nr.244/2007 dhe plotësimi i saj i datës 25.06.2009; Ekspertiza financiare e datës 18.05.2010, nga Eksperti Sh.M. e përpiluar në lëndën I.C.nr.244/2007;

Gjykata pasi ka bërë vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, dhe mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për arsyet si në vijim:

Në mes palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestues fakti se këtu paditësi, me qëllim të garantimit të përmbushjes së obligimeve nga raporti kontraktual i të paditurit me subjektin e huaj Profine GMBH ka lëshuar garancionin bankar në vlerë prej 100,000.00 EUR dhe atë me efekt deri më datë 31.12.2004, fakt ky që vërtetohet edhe nga garancioni nr. G -22.12/04. Po ashtu nuk ishte kontestues fakti që kohëzgjatja e këtij garancioni ishte vazhduar për periudhën kohore deri më datë 21.07.2005, fakt ky që vërtetohet po ashtu nga aneksi i garancionit G -22.12/04.

Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte baza juridike e kërkesëpadiës, konkretisht fakti se a i takon paditëses e drejta që të kërkoj kthimin e garancionit të paguar ndaj subjektit të huaj Profine GbmH për llogari të palës paditëse si dhe a është përfshirë kërkesa e paditësit në parashkrim.

Nga provat tjera të administruara, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Nga parashtrësia e datës 28.03.2006, gjykata konstatoi se e paditura, i është drejtuar palës paditëse duke e njoftuar të njëjtën se i padituri e konteston kërkesën për pagesën e garancionit bankar nr. G-22/12/04 dhe aneksit të saj të kërkuar nga subjekti Profine GbmH, me arsyetimin se pala e paditur, ka përmbushur obligimet ndaj subjektit të huaj të lartcekur në vlerë prej 225,999.13 EUR, ashtu që ka kërkuar nga paditësja që ta anuloj garancionin dhe ta informoj palën shfrytëzuese të garancionit se nuk ka bazë për realizimin e këtij garancioni.

Nga aktgjykimi II.C.nr. 299/07 i datës 29.01.2008, konstatohet se Gjykata Ekonomike e Qarkut ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e subjektit paditës Profine GmbH me seli në Prishtinë, dhe ka detyruar këtu paditësen (ish-Kasabanka) që t'ia paguaj paditësit shumën e borxhit prej 100,000.00 EUR në emër të garancisë së lëshuar bankare, me kamatë vjetore prej 4.5% e cila normë në vendin e përmbushjes paguhet në deponime kursimore pa caktim destinimi mbi një vit, duke filluar prej datës 07.05.2004 e deri në pagesën definitive si dhe në emër të shpenzimeve procedurale shumën prej 944.20 euro, në afat prej tetë (8) ditësh nga pranimi i aktgjykimit, nën

kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Aktgjykimi në fjalë, ishte vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, fakt ky i cili konstatohet nga aktgjykimi Ae.nr.122/2008 i datës 08.11.2011

Nga propozimi për përmbarim i datës 17.12.2012, i lejuar sipas aktvendimit E.nr. 109/12 të datës 06.03.2012, gjykata gjeti se subjekti i huaj Profine GmbH ka iniciuar procedurë përmbarimore ndaj këtu paditëses NLB Prishtina, për realizimin e borxhit në bazë të titullit ekzekutiv, aktgjykim i plotfuqishëm dhe i formës së prerë i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë II C.nr. 299/08 i datës 29.01.2008 për shumat e gjykuara si në këtë aktgjykim.

Nga urdhëresa për transferim të mjeteve monetare Pnr.582/15 e datës 23.04.2015, gjykata vërtetoi faktin se Përmbaruesi Privat Eset Murati, ka lëshuar urdhëresë që mbi bazën e aktgjykimit të plotfuqishëm II.C.nr. 299/07 të datës 29.01.2008, nga llogaria bankare e këtu paditëses, të bartën mjetet në llogari të Përmbaruesit Privat e për llogari të palës Profine GmbH, shumat si në vijim: për borxhin kryesor në emër të garancionit 100,000.00 EUR, për shpenzime të procedurës kontestimore shumë prej 944.20 EUR, për kamatë shumë prej 52,996.96 EUR, për shpenzime të procedurës përmbarimore shumë prej 3,704.58 EUR, apo në total shumë prej 157.645.75 EUR.

Nga Pasqyra bankare e lëshuar nga BQK për llogarinë bankare të paditëses, gjykata vërtetoi faktin se paditësit, nga llogaria bankare e tij, me datë 24.04.2015 i janë tërhequr mjetet në vlerë prej 157.645.75 EUR sipas urdhëresës për transferim të Përmbaruesit Privat Eset Murati.

Nga Aktvendimi I.C.nr.244/2007 i datës 27.09.2010, gjykata konstatoi se në çështjen kontestimore të zhvilluar në mes të paditësit Profine GmbH kundër të paditurit Agro-Butrinti, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, në pikën I të dispozitivit ka shfuqizuar aktvendimin për lejimin e përmbarimit E.nr. 245/07 të datës 19.06.2007, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paditësi Profine GmbH ka tërhequr padinë.

3. Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i Gjykatës

Meqenëse raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse është krijuar në vitin 2004, për vendosje në këtë çështje juridike kontestimore gjykata iu referua Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 30 mars 1978 i ish RFSJ-së, (tutje si LMD).

Me nenin 1083 par. 1 të LMD-së përcaktohet se *“Banka me garancinë e vet obligohet ndaj marrësit të garancisë (shfrytëzuesit) që në rast se personi i tretë nuk ia përmbush detyrimin në afatin e rrjedhur për pagesë t'i paguajë detyrimin në qoftë se do të përmbushen kushtet e shënuara në garancinë. Garancia duhet të jepet në formë shkresore”*. Ndërsa, me nenin 1087 par.2 parashihet se *“Urdhërdhënësi ka për detyrë t'i paguajë bankës çdo shumë që e ka paguar banka në bazë të garancisë të lëshuar me klauzolën nga paragrafi paraprak”*.

Referuar dispozitave të lartcekura, dhe nga gjendja faktike e vërtetuar në rastin konkret, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar kjo për faktin se nga provat e administruara dhe atë nga garancioni bankar nr. G -22.12/04 gjykata vërtetoi faktin se paditësja, në cilësinë e bankës, ka marrë obligim që në rast se këtu pala e paditur A... SH.P.K nuk i përmbush detyrimet ndaj subjektit të huaj Profine GmbH, detyrimet në fjalë do përmbushen ndaj shfrytëzuesit pa asnjë kundërshtim. Paditësja, ka vepruar fillimisht sipas sugjerimeve të këtu palës së paditur, duke mos e ekzekutuar garancionin në mënyrë vullnetare ndaj shfrytëzuesit të saj Profine GmbH, por që përfundimisht, detyrimi i këtu paditëses, që të paguaj garancionin nr. G -22.12/04 në vlerë prej 100,000.00 EUR për llogari të shfrytëzuesit, është vërtetuar përmes aktgjykimit I.C.nr.244/2007 i datës 27.09.2010 ku është konstatuar se garancioni bankar është kontraktuar sipas klauzolës *“pa kundërshtim”*. Ndërsa, garancioni është ekzekutuar në procedurën përmbartimore Pnr.582/15 të datës 23.04.2015, ekzekutim ky që ka përfshirë për borxhin kryesor në emër të garancisë së dhënë 100,000.00 EUR, shpenzimet e procedurës kontestimore prej 944.20 EUR, kamatën ligjore prej 52,996.96 EUR, dhe shpenzime e procedurës përmbartimore prej 3,704.58 EUR, apo në total shumë prej 157.645.75 EUR.

Nga të lartcekurat, me ekzekutimin e garancionit bankar në procedurë përmbartimore mbi bazën e aktgjykimit të formës së prerë nga paditësja për shfrytëzuesin Profine GmbH, në kuptim të nenit 1087 par.2 të LMD-së, paditëses i ka lindur e drejta që të kërkoj nga urdhërdhënësi i garancisë, këtu pala e paditur, kthimin (regresin) e pagesës sipas garancionit bankar G -22.12/04 në vlerë prej 100,000.00 EUR.

Pretendimet e palës së paditur se kërkesa e paditësit për regres të garancisë së paguar është përfshirë në parashkrim pasi që sipas nenit 361 par.2 të LMD-së i cili përcakton se *“Në qoftë se detyrimi konsiston në atë që diçka të mos bëhet, të lihet pa u bërë ose të pësohet, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur debitori të ketë vepruar në kundërshtim me këtë detyrim”*, rezulton se afati i parashkrimit ka filluar të rrjedh nga data 28.03.2006, datë kjo kur i padituri e ka njoftuar me shkrim paditësin që të mos veproj me ekzekutim të garancionit gjykata

e vlerësoj në tërësi si të paqëndrueshëm. Deri tek ky përfundim gjykata erdhi pasi që dispozita nga neni 361 par.2 i LMD-së në të cilën pala e paditur ka mbështetur pretendimin e tij, aplikohet në rastet kur pala debitore në marrëdhënien juridiko-detyimore ka një detyrim të caktuar për mos veprim ndaj palës kreditore, ashtu që tek kjo formë e detyrimit, e drejta në kërkesë kreditorit i lind nga dita e mos veprimit të palës debitorë dhe afati i parashkrimit rrjedh ditën e parë vijuese pas kësaj date.

Ndërsa në rastin konkret, i padituri si debitor, ka pasur detyrim monetar paditësit si kreditor, pra detyrimin e kthimit të mjeteve të paguara nga paditësi në emër të garancisë bankare. Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se e drejta e paditëses për të kërkuar kthimin e garancisë së kontraktuar nga i padituri si urdhërdhënëse ka lindur me datë 24.05.2015, datë kjo kur paditësit në procedurë përmbarimore i është ekzekutuar garancioni bankar për interes të shfrytëzuesit të saj, subjektit Profine GmbH, kjo në përputhje me nenin 300, të LMD-së i cili parasheh se *“Kur detyrimin e përmbush personi që ka ndonjë interes juridik në këtë, atëherë i kalohet këtij, në bazë të vetë të drejtës në momentin e përmbushjes kërkesa e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore”*.

Rrjedhimisht, meqenëse e drejta e paditësit për të kërkuar regresin e shumës së paguar në emër të garancionit bankar ka lindur me rastin e përmbushjes në mënyrë të detyrueshme në procedurë përmbarimore me datë 24.04.2015, rezulton se afati i parashkrimit për realizimin e kësaj kërkesë, ka filluar të rrjedh ditën vijuese, pra me datë 25.04.2015, kjo në mbështetje të nenit 361, par.1 të LMD-së me të cilin parashihet se *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Kësisoj, paditësja si garantuese, derisa nuk ka paguar garancionin ndaj subjektit shfrytëzues, nuk ka pasur asnjë të drejtë të kërkesës në raport me të paditurën si urdhërdhënëse, por që kjo e drejtë e regresimit, i është lindur në momentin që pasuria e paditësit është zvogëluar përmes pagesës në procedurë përmbarimore për shfrytësuesin Profine GmbH, dhe atë në interes të urdhërdhënësit, këtu të paditurës A... Sh.P.K.

Gjykata pati parasysh pretendimet e palës së paditur se banka si paditëse nuk është dashur që të bëjë ekzekutimin e garancionit ndaj shfrytëzuesit, kjo për faktin se i gjithë detyrimi që i padituri ka pasur ndaj subjektit të huaj Profine GmbH veçse ka qenë i përmbushur, përmbushje kjo që është vërtetuar edhe në procedurën gjyqësore sipas shenjës I.C.nr. 244/2007 dhe nga ekspertizat e nxjerra nga eksperti F.T. dhe eksperti Sh.M., por që këto kundërshtime, paditësja si garantuese

nuk ka mundur t'i ngrit ndaj subjektit Profine GmbH si shfrytëzuese meqenëse garancioni ka qenë i kontraktuar me klauzolën “pa kundërshtim”, kjo në përputhje me nenin 1087 par.1 të LMD-së i cili parasheh se *“banka nuk mund të theksojë ndaj shfrytëzuesit kundërshtime që urdhërdhënësi, si debitor mund t'i theksojë ndaj shfrytëzuesit sipas detyrimit të siguruar”*.

Rrjedhimisht, të gjitha kundërshtimet që këtu pala i paditur ka në raport me palën shfrytëzuese të garancionit Profine GmbH, është dashur që t'i trajtoj në një proces të veçantë kontestimor, por që banka si dhënëse e garancisë, nuk mund të marrë barrën e pasurimit eventual të pabazë të shfrytëzuesit të garancionit bankar. Për më tepër, detyrimi i paditëses që të ekzekutoj garancinë në shumë prej 100,000.00 EUR, përveç që është përcaktuar me garancionin G -22.12/04, është vërtetuar edhe me aktgjykim të formës së prerë, e rrjedhimisht detyrimi i bankës për pagesën e kësaj garancie paraqet fakt të gjykuar në procedurë gjyqësore. Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke detyruar të paditurën që në emër të kthimit (regresit) të garancisë bankare t'ia paguaj paditësit shumën prej 100,000.00 EUR.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për shumën prej 57.645.74 EUR, për faktin se shuma në fjalë, e cila përbën shpenzimet e procedurës kontestimore sipas aktgjykimit II.C.nr. 299/07, kamatën ligjore prej 52,996.96 EUR dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore prej 3,704.58 EUR janë krijuar si rezultat i veprimeve të pandërgjegjshme të këtu palës paditëse me mos ekzekutimin e garancionit bankar G -22.12/04 në mënyrë vullnetare, përkundër faktit që ky garancion është kontraktuar me klauzolën “pa kundërshtim”.

Rrjedhimisht, vonesat e palës paditëse në realizimin e garancionit bankar ndaj palës shfrytëzuese nuk mund t'i atribuohen këtu palës së paditur, përkundër kërkesave të kësaj të fundit që garancioni mos të ekzekutohet, kjo pasi që banka, ka qenë në dijeni se garancioni me klauzolën “pa kundërshtim” nuk i jep mundësi të njëjtës që të paraqes kundërshtime ndaj palës shfrytëzuese. Andaj, për këtë pjesë të kërkesëpadisë, paditësi, me veprimet e veta ka ndikuar në pakësimin e pasurisë së tij, ashtu që referuar nenit 192 par.1 të LMD-së me të cilin parashihet se *“ I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose te jetë më i madh nga sa do të ishte zakonisht, ka të drejtë vetëm për kompensim përpjestimisht të pakësuar.”* u vendos si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u refuzuar pjesa e kërkesëpadisë për shumën 57.645.74 EUR.

Meqenëse e drejta e paditësit për të kërkuar regresimin e shumës së paguar në emër të garancisë bankare ka lindur me datë 25.04.2015 atëherë gjykata, për dallim nga gjykimi i kërkesës kryesore, në raport me kamatën ligjore dhe lartësinë e saj, iu referua nenit 382 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 2012, në fuqi në kohën kur kërkesa e paditësit është bërë e arritshme dhe i cili përcakton se *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së ashtu që në rastin konkret, shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim ndaj paditësit, i referohen për taksë gjyqësore për padi në vlerë prej 500.00 EUR, taksës gjyqësore për aktgjykim 500,00. EUR, dhe taksës gjyqësore për ankesë 30.00 EUR apo në total shumën prej 1,030.00 EUR. Gjykata refuzoi pjesën tjetër të shpenzimeve të procedurës të kërkuara nga paditësi, kjo meqenëse referuar neni 453 par.1 të LPK-së, shpenzimet rreth përpilimit të parashtrësave dhe përfaqësimit pranë gjykatës i njihen palës vetëm nëse është i përfaqësuar nga avokati apo përfaqësuesit të cilit me ligj i takon e drejta që t'i njihen shpenzimet, e që nuk rezulton të jetë në rastin konkret.

Nga arsyet e cekura më lartë, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 310/22, datë 07.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.